



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE
SANKSIONEVE

Data: 04 Maj 2021

Nr: 54

VENDIM I NDËRMJETËM
PËR SHQYRTIMIN BASHKËRISHT TË KËRKESAVE ANKIMORE NR. 27, NR. 28, NR. 29,
NR. 30 DHE NR. 31

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 04.05.2021, me pjesëmarrjen e:

| | | |
|-----------------|---|---------|
| Elvis ÇEFA | - | Relator |
| Elvin LAKO | - | Anëtar |
| Ilirjan RUSMALI | - | Anëtar |
| Koli BELE | - | Anëtar |
| Ledio BRAHO | - | Anëtar |

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për shqyrtimin bashkërisht të kërkesave ankimore nr. 27, nr. 28 nr. 29, nr. 30 dhe nr. 31 të paraqitura në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve në datën 30.04.2021 dhe në datën 04.05.2021.

BAZË LIGJORE: Nenet 21, pika 1, shkronja “b”, 132 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; nenin 19 të vendimit nr.03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve” dhe neni 65, shkronja “ç” i ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”.



Data: 04 Maj 2021
Nr. 54, ora 14:20

Për shqyrtimin bashkërisht të kërkesave ankimore nr. 27, nr. 28, nr. 29, nr. 30 dhe nr. 31 të depozituara në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

V Ë R E N:

Anëtarët e KZAZ-së nr. 66, qarku Berat, kanë paraqitur pranë KQZ-së kërkesë ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 27 regj, datë 30.04.2021. Objekti i kësaj kërkesë ankimore është kundërshtimi i vendimit nr. 306, datë 26.04.2021 të KSHZ-së “Për konstatimin dhe shqyrtimin e kundërvajtjes administrative për shkelje të Kodit Zgjedhor nga anëtarët dhe sekretari KZAZ-së nr. 66, qarku Berat”.

Anëtarët e KZAZ-së nr. 38, qarku Tiranë kanë paraqitur pranë KQZ-së kërkesë ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 28 regj, datë 30.04.2021. Objekti i kësaj kërkesë ankimore është kundërshtimi i vendimit nr. 318, datë 26.04.2021 të KSHZ-së “Për konstatimin dhe shqyrtimin e kundërvajtjes administrative për shkelje të Kodit Zgjedhor nga anëtarët dhe sekretari i KZAZ-së nr. 38, qarku Tiranë”.

Po ashtu, anëtarët e KZAZ-së nr. 2, qarku Shkodër kanë paraqitur pranë KQZ-së kërkesë ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 29 regj, datë 30.04.2021. Objekti i kësaj kërkesë ankimore është kundërshtimi i vendimit nr. 313, datë 26.04.2021 të KSHZ-së “Për konstatimin dhe shqyrtimin e kundërvajtjes administrative për shkelje të Kodit Zgjedhor nga anëtarët dhe sekretari i KZAZ-së nr. 2, qarku Shkodër”.

Anëtarët e KZAZ-së nr. 20, qarku Durrës kanë paraqitur pranë KQZ-së kërkesë ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 30 regj, datë 30.04.2021. Objekti i kësaj kërkesë ankimore është kundërshtimi i vendimit nr. 307, datë 26.04.2021 të KSHZ-së “Për konstatimin dhe shqyrtimin e kundërvajtjes administrative për shkelje të Kodit Zgjedhor nga anëtarët dhe sekretari i KZAZ-së nr. 20, qarku Durrës”.

Anëtarët e KZAZ-së nr. 21, qarku Durrës kanë paraqitur pranë KQZ-së kërkesë ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 31 regj, datë 30.04.2021. Objekti i kësaj kërkesë ankimore është kundërshtimi i vendimit nr. 308, datë



26.04.2021 të KSHZ-së “Për konstatimin dhe shqyrtimin e kundërvajtjes administrative për shkelje të Kodit Zgjedhor nga anëtarët dhe sekretari i KZAZ-së nr. 21, qarku Durrës”.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, në datën 04.05.2021, vendosi të kalonte për shqyrtim pesë kërkesat ankimore të paraqitura në KQZ në datën 30.04.2021 dhe në datën 04.05.2021. Relatorët e kërkesave ankimore, përkatësisht z. Elvis Çefa, z. Elvin Lako dhe z. Ledio Braho konstatuan se të pesta kërkesat ankimore kundërshtojnë sanksionet administrative të vendosura nga Komisioneri në bazë të nenit 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor. Të pesë kërkesat janë iniciuar nga KZAZ që ankimojnë vendimmarrje të KSHZ-së që lidhen me afatin e parashikuar në pikën 1 të nenit 122 të K.Zgjedhor.

Neni 65 shkronja “ç” i K.Pr.Administrative parashikon se “Në fillim të procedurës administrative, organi publik kryen verifikimet e mëposhtme: ... ç) nëse kërkesa e një pale për fillimin e një procedure administrative mund të shqyrtohen së bashku me kërkesat e palëve të tjera, nëse bazohet në të njëjtat fakte dhe bazë ligjore”.

Duke qenë se kërkesa ankimore nr. 27, datë 30.04.2021 është regjistruar më parë në regjistrin e ankimimeve se kërkesat ankimore nr. 28, nr. 29, nr. 30 dhe nr. 31 atëherë të pesë kërkesat ankimore do të relatohen nga z. Elvis Çefa.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve mbështetur në nenet 21, pika 1, shkronja “b” dhe 132 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 19 pika 1, të vendimit nr.03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve” dhe neni 65, shkronja “ç” i ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”.

VENDOSI:

1. Shqyrtimin bashkërisht të kërkesave ankimore nr. 27, datë 30.04.2021, të paraqitur nga anëtarët e KZAZ-së nr. 66, qarku Berat; nr. 28, datë 30.04.2021, të paraqitur nga anëtarët e KZAZ-së nr. 38, qarku Tiranë; nr. 29, datë 30.04.2021, të paraqitur nga anëtarët e KZAZ-së nr. 2, qarku Shkodër; nr. 30, datë 04.05.2021 të paraqitur nga anëtarët dhe sekretari i KZAZ-së nr. 20, qarku Durrës dhe nr. 31, datë 04.05.2021, të paraqitur nga anëtarët dhe sekretari i KZAZ-së nr. 21, qarku Durrës.
2. Shqyrtimi do të bëhet në datën 05.05.2021, ora 13:00, nga relatori z. Elvis Çefa.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.



4. Vendimi është i formës së prerë dhe nuk mund të bëhet ankim.

| | | | |
|----------------|----------------|---|----------------|
| Elvis | ÇEFA | - | Relator |
| Elvin | LAKO | - | Anëtar |
| Ilirjan | RUSMALI | - | Anëtar |
| Koli | BELE | - | Anëtar |
| Ledio | BRAHO | - | Anëtar |

